

Vendim nr. 243 datë 30.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SHKËLQIM RUGOVA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 3, datë 19.02.2019 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 49, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (*DPSHTRR*), në detyrën e inspektorit të kontrollit rrugor në bazë të urdhrit

nr. 586, datë 04.11.2010. Me vendimin nr. 203, datë 05.12.2013 të DPSHTRR-së është vendosur zgjidhja e marrëdhënies së punës.

2. Në datën 11.04.2014 kërkuesi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt pavlefshmërinë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe dëmshpërblimet përkatëse, sipas dispozitave të Kodit të Punës që rrjedhin nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e marrëdhënies së punës. Me vendimin nr. 3799, datë 07.07.2014, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, detyrimin e DPSHTRR-së t'i paguajë kërkuetit pagën e 10 muajve për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe rrëzimin për sa u përket kërtimeve të tjera të saj. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit kërkuesi dhe DPSHTRR-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 137, datë 29.01.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr. 3, datë 19.02.2019, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 137, datë 29.01.2015 të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3799, datë 07.07.2014 të gjykatës së shkallës së parë. Ndër të tjera, ai kolegji ka vlerësuar se në zgjidhjen e çështjes në gjykim nga të dyja gjykatat më të ulëta, drejt ka vepruar gjykata administrative e shkallës së parë, e cila e ka cilësuar zgjidhjen e marrëdhënies së punës si zgjidhje të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme, duke pranuar pjesërisht padinë.

5. Në datën 30.06.2025 (*nëpërmjet shërbimit postar*), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrimet e përcaktuara nga neni 482 i Kodi i Procedurës Civile lidhur me njoftimin për datën dhe orën e gjykimit edhe pse gjykimi është zhvilluar në dhomën këshillimit.

- 6.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Kjo gjykatë nuk është shprehur për kërkimin për sa i përket dëmit shëndetësor, duke cenuar në këtë mënyrë edhe të drejtën e aksesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vërehet se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, konstatohet se në ankimin kushtetues individual kërkuari pas më shumë se 6 vjetësh ka kundërshtuar vendimin nr. 3, datë 19.02.2019 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar. Sipas informacionit

të marrë nga Gjykata e Lartë në rrugë elektronike, rezulton se ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 21.03.2019, datë kur palët mund ta dispononin atë, kurse ankimi është paraqitur në shërbimin postar në datën 30.06.2025.

12. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, kërkuesi ka pretenduar se ka probleme të shëndetit mendor dhe bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ka paraqitur raportin mjekësor epikrizë nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr. 3, Tiranë, sipas të cilit ai ka probleme shëndetësore dhe ka bërë një shtrim në Klinikën e Psikiatrisë në vitin 2018 me atak paniku pa përcaktuar kohëzgjatjen e shtrimit, si edhe merr kurimin përkatës.

13. Kërkuesi nuk ka pretenduar se nuk është njohur me vendimin e kundërshtuar ose me datën në të cilën është vënë efektivisht në dijeni të tij. Për më tepër, rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka gjetur të bazuara shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili ka pranuar pjesërisht padinë e paraqitur prej tij.

14. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që ai ka qenë i shtruar në vitin 2018, pra përpara vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk mund të përbëjë si shkak për të justifikuar një afat kaq të gjatë (6 vjet), nga data e publikimit më 21.03.2019. Argumentet e kërkuesit nuk janë të tilla që të mund të justifikojnë një vonesë të atillë në konstatimin e cenimit dhe, për rrjedhojë, në paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për këto arsye, Kolegji çmon se kërkuesi nuk përmbush kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

15. Në vështrim të rrethanave të mësipërme, Kolegji vlerëson se kërkesa drejtuar Gjykatës është paraqitur dukshëm tej afatit ligjor 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues dhe kërkesa e paraqitur nga ai nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.